

# **PROJEKTLIGJ (V10)**

Nr. , datë ..

## **"PËR KINEMATOGRAFINË DHE AUDIOVIZUALIN"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

### **VENDOSI:**

#### **KREU I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1**

##### **Objekti**

Ky ligj ka për objekt rregullimin e veprimtarisë kinematografike dhe audiovizuale në Republikën e Shqipërisë, nxitjen e krijimtarisë, zhvillimin, promovimin dhe prodhimin të veprave kinematografike dhe audiovizuale, mbështetjen financiare për prodhimet vendase dhe të huaja të realizuara në territoret e Republikës së Shqipërisë, me qëllim zhvillimin dhe promovimin e industrisë kinematografike dhe audiovizuale, si dhe ruajtjen e trashëgimisë kinematografike dhe audiovizuale Shqiptare.

##### **Neni 2**

##### **Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim:

- a) mbështetjen e zhvillimit të sektorit të kinematografisë dhe audiovizualit;
- b) nxitjen e krijimtarisë artistike dhe inovacionit;
- c) promovimin e kinematografisë dhe audiovizualit dhe identitetin kulturor shqiptar;
- d) ruajtjen dhe zhvillimin e diversitetit gjuhësor dhe kulturor;

- e) rritjen e konkurrueshmërisë së industrisë kinematografike dhe audiovizuale;
- f) tërheqjen e investimeve të huaja në sektorin kinematografik dhe audiovizual;
- g) promovimin e Shqipërisë si destinacion filmik;
- h) nxitjen e kushteve që favorizojnë rritjen e ekosistemit dhe industrisë kinematografike dhe audiovizuale në Shqipëri;

### **Neni 3**

#### **Fusha e zbatimit**

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjithë personat fizikë dhe juridikë si dhe institucionet në Republikën e Shqipërisë, të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e kinematografisë dhe audiovizualit.

### **Neni 4**

#### **Përkufizimet**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "AKKA" është Agjencia Kombëtare e Kinematografisë dhe Audiovizualit.
- b) "Aktivitete plotësuese filmike dhe audiovizuale" janë aktivitetet që mbështesin zhvillimin, promovimin, edukimin, qarkullimin dhe ruajtjen e kulturës kinematografike dhe audiovizuale, si dhe fuqizimin e filmbërësve të rinj dhe profesionistëve të sektorit. Këto përfshijnë, ndër të tjera, promovimin e trashëgimisë kinematografike, organizimin e festivaleve, tregjeve filmike dhe platformave publike, botime dhe kërkime në fushën e kinemasë, rezidenca artistike, forume profesionale, si dhe programe edukimi, trajnimi, mentorimi dhe ngritjeje profesionale për profesionistët e industrisë, me synim zhvillimin artistik, inovacionin, rritjen e kapaciteteve dhe qasjen në tregun kombëtar dhe ndërkombëtar.
- c) "Bashkëprodhim" është prodhimi filmik i realizuar në bashkëpunim nga dy ose më shumë prodhues shqiptarë ose të huaj, të cilët kontribuojnë financiarisht, artistikisht dhe/ose teknikisht në realizimin e veprës, sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet tyre, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.

- d) "Bashkëprodhim mazhoritar" është vepra filmike ose audiovizuale ku kontributi financiar, artistik dhe/ose teknik i produksionit shqiptar në realizimin e veprës përbën përqindjen më të madhe të buxhetit total të veprës, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi;
- e) "Bashkëprodhim në pakicë" është vepra filmike ose audiovizuale ku kontributi financiar, artistik dhe/ose teknik i produksionit shqiptar në realizimin e veprës është jo më pak se 5 (pesë) për qind dhe jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) për qind e buxhetit total të veprës, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.
- f) "Distributor" është personi fizik ose juridik i cili kryen veprime ose ofron shërbime për shpërndarjen dhe qarkullimin e veprave filmike ose audiovizuale, duke përfshirë promovimin, shfaqjen në sallat e kinemasë, shitjen, dhënien me qira, transmetimin ose çdo formë tjetër të vënies në dispozicion të publikut, sipas marrëveshjes së lidhur me mbajtësit e të drejtave, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi;
- g) "Film" ose "vepër kinematografike" është krijimi kinematografik i përbërë nga një sekuencë planesh filmike të ndërlidhura, i shoqëruar me ose pa zë, që krijojnë efektin e lëvizjes, realizuar si një krijim i vetëm, e fiksuar në çfarëdo teknike apo bartësi material, e çdo metrazhi dhe zhanri, i destinuar për shfaqjeje publike ose komunikimi me publikun.
- h) "Kinema autoriale" është tërësia e veprave kinematografike, në të cilën vizioni origjinal i autorit ka peshën mbizotëruese në zgjedhjet artistike, estetike dhe narrative, i pakushtëzuar nga kërkesat dhe dinamikat e tregut;
- i) "Profesionist i industrisë kinematografike dhe audiovizuale" është idnividi ose personi fizik që ushtron veprimtari krijuese, artistike, teknike ose profesionale në çdo fazë të zhvillimit, prodhimit, realizimit, pasprodhimit, shpërndarjes dhe promovimit të veprave kinematografike dhe audiovizuale.
- j) "Materiale të arkivueshme" janë të gjitha materialet përcjellëse të veprës kinematografike ose audiovizuale, të cilat kanë interes dokumentar, historik, artistik ose teknik për qëllime arkivimi, të cilat përfshijnë ndër të tjera, skenarin, fotografitë, materialet promovuese, kostumografinë, skenografinë, aparaturat, rekuizitat dhe çdo element tjetër shoqërues që lidhet me procesin e krijimit dhe shfaqjes së veprës."
- k) "Producent" është personi fizik ose juridik, që merr përsipër zhvillimin, financimin dhe realizimin e veprës kinematografike ose audiovizuale, duke organizuar dhe mbështetur financiarisht procesin e prodhimit, me fonde

private ose publike, i cili gëzon të drejtën e shfrytëzimit ekonomik mbi veprën e realizuar, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi

- l) "Prodhim kinematografik ose audiovizual" është procesi i plotë i krijimit të një vepre kinematografike ose audiovizuale, që përfshin të gjitha fazat nga koncept-idea, zhvillimi i projektit, paraprodhimi, prodhimi, pasprodhimi, deri te shfaqja, qarkullimi, shpërndarja, promovimi dhe çdo aktivitet tjetër i lidhur me komunikimin e saj me publikun.
- s) Prodhim i kualifikuar" është një prodhim kinematografik ose audiovizual që përmbush pragun minimal të shpenzimeve të pranueshme të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kriteret, kushtet dhe procedurat e përcaktuara me akte nënligjore;
- t) "Regjisor" është autori që mban përgjegjësinë artistike për realizimin e veprës kinematografike ose audiovizuale, duke drejtuar procesin krijues, ekipin artistik dhe teknik dhe që zotëron shtetësinë shqiptare;
- u) "Rimbursim i shpenzimeve" (Cash Rebate) është mekanizëm mbështetës financiar që konsiston në kthimin e një përqindjeje të shpenzimeve të kualifikuara dhe të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë për prodhime kinematografike dhe audiovizuale të çertifikuara, në përputhje me kriteret e parashikuara.
- v) "Serial" është vepra audiovizuale e fiksuar në çfarëdo teknike apo bartësi material, e çdo metrazhi dhe zhanri, e strukturuar në episode të ndërlidhura, të cilat përbëjnë një tërësi narrative ose tematike, pavarësisht platformës ose mjetit të transmetimit ku shfaqet.
- w) "Skenarist" është autori i tekstit origjinal ose të përshtatur të veprës kinematografike ose audiovizuale, që përcakton strukturën narrative, personazhet dhe dialogjet;
- x) "Sallë e shfaqjes kinematografike" është hapësirë e posaçme, e përshtatur dhe e destinuar për shfaqjen publike të veprave kinematografike, me një ose disa ekrane, e hapur për publikun, me apo pa pagesë, pavarësisht nëse kjo hapësirë është e përhershme apo sezonale, si dhe pavarësisht vendndodhjes apo pronësisë së saj;
- y) "Shfaqës ose transmetues" është personi fizik ose juridik i cili mban të drejtat sipas ligjit për shfaqjen/transmetimin publik të një vepre kinematografike ose audiovizuale, pavarësisht ambientit apo platformës digjitale të përdorura, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fuqi.
- z) "Shtëpi kinematografike" është personi fizik ose juridik që ushtron veprimtari në fushën e prodhimit kinematografik dhe audiovizual, që

organizon, menaxhon dhe mbështet financiarisht procesin e prodhimit të veprës kinematografike ose audiovizuale, si dhe gëzon të drejtat e shfrytëzimit ekonomik të veprës kinematografike ose audiovizuale, në përputhje me legjislacionin e zbatueshën në fuqi.

- aa) "Shpenzime të kualifikuara" janë shpenzimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë, që lidhen me realizimin e prodhimeve kinematografike ose audiovizuale, të përcaktuara me akt nënligjor;
- bb) "Vepër audiovizuale" është çdo krijim audiovizual, që përmban sekuenca planesh filmike të ndërlidhura, të shoqëruara me apo pa zë, të cilat krijojnë efektin e lëvizjes, e konceptuar dhe e realizuar si një krijim unitar ose serial, e fiksuar në çfarëdo teknikë apo bartës material, të çdo metrazhi dhe zhanri, në krijimin e së cilës përcaktohet qartë puna e krijimit, prodhimit, montazhit dhe pasprodhimit, e krijuar dhe destinuar për t'u shfaqur kryesisht nëpërmjet mjeteve televizive apo platformave elektronike apo digjitale.
- cc) "Vepër audiovizuale ndërvepruese" (vepër imersive) është çdo krijim audiovizual që ofron një përvojë shikimi dinamike dhe ndërvepruese, ku zhvillimi i përmbajtjes mund të varet plotësisht ose pjesërisht nga ndërveprimi i përdoruesit dhe/ose nga lëvizja e tij në hapësirën vizuale dhe zanore, duke përfshirë teknologjitë e realitetit virtual (VR), realitetit të shtuar (AR), realitetit të përzier (MR), ose çdo teknologji apo pajisjeje tjetër që mundëson përfshirje ndërvepruese të përdoruesit në veprën audiovizual dhe që janë të destinuara për shpërndarje ose shfaqje përmes platformave fizike ose digjitale;
- dd) "Vepër debutuese dhe e dytë" është vepra e parë dhe e dytë kinematografike ose audiovizuale e regjisorit, e destinuar për shfaqje dhe/ose shpërndarje publike, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tij nënligjore;
- ee) "Vepër kinematografike ose audiovizuale shqiptare" është vepra e realizuar nga një producent, skenarist dhe/ose regjizor me shtetësi shqiptare, ose vepër e realizuar në bashkëprodhim me një a më shumë producentë të tjerë vendas a të huaj, kur regjizori dhe/ose producenti janë shtetas shqiptarë, bashkëprodhimi është mazhoritar, si dhe në përmbajtjen e veprës së realizuar mbizotërojnë elemente kulturore shqiptare si kultura, gjuha, tematika, vendi i xhirimit, apo elemente të tjerë kulturorë kombëtar.
- ff) "Videolojë" është çdo program, i vënë në dispozicion të publikut në formë fizike ose digjitale, që përfshin elemente të krijimit artistik dhe teknologjik, duke i propozuar një ose më shumë përdoruesve një seri ndërveprimesh të

bazuara në një linjë të strukturuar skenari ose në situata të simuluar, dhe që shfaqet në formë imazhesh të animuara, me ose pa zë.

## **KREU II**

### **AGJENCIA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË DHE AUDIOVIZUALIT**

#### **Neni 4**

#### **Statusi dhe organizimi**

1. Agjencia Kombëtare e Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA) krijohet si person juridik publik, buxhetor, me statusin e institucionit qendror, në varësi të ministrisë përgjegjëse për kulturën.
2. Agjencia Kombëtare e Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA) ka qëllim të mbështesë dhe zhvillojë kinemanë dhe audiovizualin në Republikën e Shqipërisë, të administrojë mbështetjen publike dhe certifikojë kualifikimin e shpenzimeve të rimbursueshme për prodhimet filmike dhe audiovizuale, të nxisë bashkëprodhimet ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në programe evropiane, si dhe të promovojë krijimtarinë shqiptare brenda dhe jashtë vendit.
3. AKKA ushtron veprimtarinë e saj mbi parimet e autonomisë artistike, transparencës financiare dhe respektimit të të drejtave të autorit.
4. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKKA rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.
5. Statuti i Agjencisë Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA) miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për kulturën.
6. Rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të AKKA propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohet nga Këshilli Drejtues.

#### **Neni 5**

#### **Kompetencat**

1. AKKA ka këto kompetenca:
  - a) Harton dhe zbaton politikat e sektorit fkinematografik dhe audiovizual në përputhje me Programin Kombëtar për Zhvillimin e Krijimtarisë Audiovizuale;

- b) administron buxhetin e saj si dhe fondet e dedikuara për zhvillimin e sektorit kinematografik dhe audiovizual,
- c) administron të ardhura nga shërbimet, programet kombëtare dhe ndërkombëtare, donacionet dhe burime të tjera të ligjshme financimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- d) nxit kulturën kinematografike dhe audiovizuale në vend me vlera artistike, kulturore dhe identitare;
- e) mbështet financiarisht prodhimet filmike dhe audiovizuale;
- f) mbështet financiarisht prodhimin e filmave nga regjisorët e rinj, debutues dhe të karrierës;
- g) bashkëfinancon aktivitetet audiovizuale brenda dhe jashtë vendit;
- h) nxit ruajtjen, përhapjen dhe studimin e trashëgimisë audiovizuale;
- i) mbështet edukimin dhe trajnimin profesional në sektorin kinematografik dhe audiovizual;
- j) promovon, programon shpërndarjen dhe qarkullimin e veprave audiovizuale të financuara nga fondet publike;
- k) bashkëpunon me shoqatat profesionale dhe subjektet e tjera për zhvillimin e sektorit filmik dhe audiovizual, si dhe stimulon pjesëmarrjen e producentëve shqiptarë në bashkëprodhime ndërkombëtare dhe programe evropiane;
- l) administron produktin kinematografik të prodhuar nga Kinostudio "Shqipëria e Re" dhe "Albafilm Studio" deri në vitin 1996;
- m) regjistron veprat kinematografike dhe audiovizuale që mbështet financiarisht;
- n) regjistron personat fizikë dhe juridikë me objekt veprimtarie në fushën kinematografike dhe audiovizuale, si dhe administron Regjistrat përkatës;
- o) mbledh, administron dhe publikon të dhëna statistikore mbi sektorin kinematografik dhe audiovizual;
- p) certifikon shpenzimet e rimbursueshme, si dhe administron dhe monitoron skemat e mbështetjes financiare sipas këtij ligji në sektorin kinematografik dhe audiovizual;
- q) organizon dhe mbështet festivale filmi dhe aktivitete kinematografike dhe audiovizuale;

- r) koordinon politikat dhe skemat sektoriale midis subjekteve publike dhe private;
- s) miraton tarifat e produkteve kinematografike dhe audiovizuale sipas kategorive;
- t) rekomandon ministrit përgjegjës për kulturën ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore të fushës.

## **Neni 6**

### **Buxheti i AKKA**

- 1. Buxheti i AKKA përbëhet nga:
  - a. Buxheti i shtetit;
  - b. të ardhurat vjetore të mbledhura në buxhetin e shtetit, nga detyrimet vjetore që shlyejnë subjektet e mëposhtme:
    - i. 5% të masës së tatimit mbi fitimin që i paguhet administratës tatimore nga subjektet që ofrojnë shërbime transmetimi, shpërndarjeje ose shfaqjeje të përmbajtjes audiovizuale në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë transmetuesit televizivë, platformat e shërbimeve online dhe operatorët e kinemave;
    - ii. 5% të masës së tatimit mbi fitimin që i paguhet administratës tatimore nga subjektet e licencuara nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për ofrimin e shërbimeve të aksesit në internet në Republikën e Shqipërisë;
    - iii. 2% të masës së tatimit mbi fitimin që i paguhet administratës tatimore nga operatorët e komunikimeve elektronike që ofrojnë shërbime telefonike dhe transmetimi të të dhënave;
  - c. të ardhura të krijuara nga tarifat e regjistrimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën kinematografike dhe audiovizuale;
  - d. të ardhura nga qarkullimi dhe shfrytëzimi i veprave kinematografike dhe audiovizuale të financuara nga AKKA;
  - e. të ardhura nga administrimi i veprave kinematografike të prodhuar nga Kinostudio “Shqipëria e Re” dhe “Albafilm Studio” deri në vitin 1996;
  - f. të ardhurat në masën 2% të çmimit të biletave të shitura në sallat e kinemave;

- g. të ardhura nga sponsorizime dhe donacione;
  - j. burime të tjera të ligjshme.
2. Të ardhurat e përcaktuara në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni derdhen në një llogari të veçantë të AKKA-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Këto të ardhura konsiderohen të ardhura të dedikuara dhe trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin buxhetor.
  3. Fondet e destinuar për financimin e projekteve kinematografike dhe audiovizuale nëpërmjet mbështetjes financiare të drejtpërdrejtë dhe granteve për zhvillimin e krijimtarisë përjashtohen nga procedurat e prokurimit publik.
  4. Tarifat për shërbimet dhe regjistrimet e AKKA përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për kulturën.

## **Neni 7**

### **Organet drejtuese**

Organet drejtuese të AKKA janë Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm.

## **Neni 8**

### **Këshilli Drejtues**

1. Këshilli Drejtues është organi kolegjal vendimmarrës dhe mbikëqyrës i AKKA-së, i cili ushtron funksione strategjike, drejtuese dhe kontrolluese për garantimin e përmbushjes së misionit, objektivave dhe veprimtarisë së saj në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. AKKA përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë:
  - a) 2 (dy) përfaqësues të industrisë kinematografike
  - b) 1 (një) përfaqësues të industrisë audiovizuale;
  - c) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për kulturën;
  - d) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat.
3. Mandati i Këshillit Drejtues është 4 (katër) vjeçar. Anëtarët nuk mund të emërohen për më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.
- 4 Anëtar i Këshillit Drejtues duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
  - a) të jetë shtetas shqiptar;

- b) të ketë të paktën 10 (dhjetë) vjet përvojë pune në fushën e kinematografisë ose audiovizualit;
- c) të ketë kontribut në fushën e kinematografisë ose audiovizualit, përmes prodhimit ose bashkëprodhimit të veprave audiovizuale, përfshirjes në projekte profesionale ose prodhime të financuara, marrjes së çmimeve ose vlerësimeve profesionale, si dhe angazhimit në aktivitete akademike ose profesionale në këtë fushë;
- ç) të mos jetë larguar nga puna me masë disiplinore;
- d) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi me dashje.

## **Neni 9**

### **Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues**

1. Shoqatat të kinematografisë dhe audiovizualit të regjistruara pranë AKKA propozojnë kandidaturat për anëtarët e Këshillit Drejtues nga radhët e industrisë. Çdo shoqatë mund të propozojë deri në 2(dy) kandidatë, të cilët duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 8 të këtij ligji.
2. AKKA verifikon përmbushjen e kushteve ligjore nga kandidatët brenda 10(dhjetë) ditëve nga paraqitja e kandidaturave, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur dhe kritereve të përcaktuara në këtë ligj.
3. Pas verifikimit, vendimi i arsyetuar i AKKA, i njoftohet kandidatit dhe subjektit propozues.
4. Kandidatët që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 8 të ligjit kualifikohen për vijimin e procedurave të votimit. Kanë të drejtë vote anëtarët e shoqatave të kinematografisë dhe audiovizualit të regjistruara pranë AKKA prej jo më pak se 3 (tre) vitesh nga data e zhvillimit të votimit.
5. Çdo anëtar i regjistruar në shoqatë gëzon të drejtën e një vote, nëse ka të paktën 3 (tre) vepra kinematografike ose audiovizuale të regjistruara në Regjistrin Kombëtar. Kandidaturat e propozuara nga shoqatat kinematografike, të regjistruara pranë AKKA-s, votohen nga lista e profesionistëve të kinematografisë dhe prej tyre zgjidhen 2 anëtarë të Këshillit Drejtues, përfaqësues nga sektori i kinematografisë. Kandidaturat e propozuara nga shoqatat e audiovizualit, të regjistruara pranë AKKA-s., votohen nga lista e profesionistëve të audiovizualit, dhe prej tyre zgjidhet një anëtar i Këshillit Drejtues, përfaqësues i sektorit për audiovizualin.

6. Përfaqësuesit e ministrive caktohen nga titullarët e institucioneve përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
7. Në përfundim të procesit, Drejtori i Përgjithshëm i AKKA emëron anëtarët e Këshillit Drejtues, pasi verifikon përputhshmërinë e procedurës së ndjekur me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
8. Procedurat për krijimin e Këshillit të parë Drejtues organizohen dhe zhvillohen nga ministria përgjegjëse për kulturën. Pas përfundimit të mandatit të parë, procedurat zhvillohen nga AKKA.
9. Kundër vendimeve të AKKA për verifikimin e kandidaturave dhe rezultateve të votimit lejohet ankimi administrativ në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat administrative.
10. Rregullat e hollësishme për mënyrën dhe procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve nga radhët e sektorit kinematografik dhe audiovizual, organizimi dhe zhvillimi i votimit, ankimi dhe procedurat e shqyrtimit të tij përcaktohen në Statutin e AKKA.

## **Neni 10**

### **Papajtueshmëritë dhe përfundimi i mandatit**

1. Anëtar i Këshillit Drejtues nuk mund të jetë personi që:
  - a) ushtron funksione drejtuese në shoqëri tregtare që kanë marrëdhënie kontraktuale në fuqi me AKKA ose janë përfitues të financimeve të saj;
  - b) ka marrëdhënie kontraktuale në fuqi me AKKA në cilësinë e përfituesit.
2. Anëtarët e Këshillit Drejtues të zgjedhur nga radhët e industrisë kinematografike dhe audiovizuale nuk mund të kenë marrëdhënie kontraktuale me AKKA gjatë kohëzgjatjes së mandatit. Çdo marrëdhënie kontraktuale duhet të përfundojë përpara fillimit të mandatit.
3. Mandati i anëtarit të Këshillit Drejtues përfundon:
  - a. me mbarimin e afatit të mandatit;
  - b. me dorëheqjen e deklaruar me shkrim;
  - c. kur ndaj tij jepet vendim gjyqësor i formës së prerë për kryerjen e një krimi me dashje;
  - ç) kur me vendim gjyqësor ndalohet ose pezullohet ushtrimi i funksioneve publike;

- d. kur mungon pa arsye të justifikuara në më shumë se tre mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit Drejtues;
  - dh) kur humbet shtetësinë shqiptare;
  - e) në rast të heqjes së zotësisë për të vepruar;
  - ë) në rast vdekje.
4. Vendi i mbetur vakant në Këshillin Drejtues plotësohet sipas procedurës së parashikuar në nenin 8 të këtij ligji, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga data e shpalljes së vakancës.

## **Neni 11**

### **Kompetencat e Këshillit Drejtues**

1. Këshilli Drejtues ushtron këto kompetenca:
- a. Miraton Programin Kombëtar për Zhvillimin e Krijimtarisë Audiovizuale dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
  - b. miraton planin financiar vjetor të AKKA sipas sektorëve të kinematografisë dhe audiovizualit dhe mbikëqyr përdorimin e fondeve;
  - c. miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të AKKA;
  - d. mbikëqyr dhe vlerëson zbatimin e politikave zhvillimore të AKKA;
  - e. miraton raporte dhe rekomandime mbi efektshmërinë e politikave të fushës së kinematografisë dhe audiovizualit;
  - f. miraton përbërjen e Këshillit Artistik dhe Komisionin e Vizionimit dhe Financiar;
  - g. miraton politikat dhe buxhetin për financimin e projekteve promovuese dhe aktiviteteve vjetore të AKKA;
  - h. miraton raportin vjetor të aktivitetit të AKKA;
  - i. miraton tarifatat e regjistrimit dhe shërbimet e ofruara nga AKKA;
  - j. miraton kriteret për mbështetjen financiare të prodhimeve kinematografike dhe audiovizuale, në përputhje me aktet nënligjore dhe Statutin e AKKA;
  - k. vendos mbi ankimimet nga subjektet konkurruese në thirrjet publike të AKKA;
  - l. miraton tarifatat e financimeve të veprave kinematografike dhe audiovizuale;
  - m. ushtron detyra të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në Statutin e AKKA.

2. Mënyra e funksionimit të Këshillit Drejtues përcaktohet në Statutin e AKKA.
3. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Artistik përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për kulturën,

## **Neni 12**

### **Drejtori i Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm është organi ekzekutiv i AKKA-së, i cili drejton dhe organizon veprimtarinë administrative dhe financiare të institucionit, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson AKKA në marrëdhëniet me të tretët dhe përgjigjet për zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues.
3. Drejtori i Përgjithshëm emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për kulturën, pas një procedure përzgjedhjeje të hapur dhe konkurruese, për një mandat 4 (katër) vjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm 1 (një) herë.
4. Drejtori i Përgjithshëm duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
  - a) të jetë shtetas shqiptar;
  - b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në fushën e kinematografisë ose audiovizualit;
  - c) të ketë kontribut në fushën e kinematografisë ose audiovizualit, përmes prodhimit ose bashkëprodhimit të veprave audiovizuale, përfshirjes në projekte profesionale ose prodhime të financuara, marrjes së çmimeve ose vlerësimeve profesionale, si dhe angazhimit në aktivitete akademike ose profesionale në këtë fushë;
  - ç) të mos jetë larguar nga puna me masë disiplinore;
  - d) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi me dashje.
5. Procedurat e hollësishme për shpalljen, përzgjedhjen dhe vlerësimin e kandidatëve përcaktohen në Statutin e AKKA.
6. Mandati i Drejtorit të Përgjithshëm përfundon para afatit në rastet kur:
  - a) humbet shtetësinë shqiptare;
  - b) deklarohet i paaftë për punë sipas legjislacionit në fuqi apo merr formë të prerë vendimi gjyqësor për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;

- c) plotëson kushtet për pension pleqërie;
  - ç) paraqet dorëheqjen me shkrim;
  - d) vërtetohet pamundësia për të ushtruar detyrën;
  - dh) i hiqet e drejta për të ushtruar funksione publike me vendim gjyqësor të formës së prerë;
  - e) gjendet në kushtet e konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
  - ë) ristrukturohet institucioni.
7. Drejtori i Përgjithshëm i AKKA shkarkohet nga detyra në këto raste:
- a) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
  - b) kryen shkelje të rënda gjatë ushtrimit të detyrës;
  - c) nuk përmbush objektivat e institucionit;
  - ç) mungon në detyrë, pa shkaqe të arsyeshme, për më shumë se 30 (tridhjetë) ditë radhazi.
8. Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të ushtrojë funksione drejtuese ose të ketë interesa financiare me subjekte që ushtrojnë veprimtari në fushën e kinematografisë dhe audiovizualit.
9. Drejtori i Përgjithshëm lirohet dhe shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për kulturën.

### **Neni 13**

#### **Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm i AKKA ushtron këto kompetenca:
- a) organizon dhe drejton veprimtarinë e AKKA, në përputhje me ligjin dhe Statutin;
  - b) përfaqëson AKKA në marrëdhëniet me të tretët dhe nënshkruan aktet juridike e financiare;
  - c) propozon rregulloren e brendshme për miratim nga Këshilli Drejtues;
  - ç) përgatit dhe propozon buxhetin vjetor të AKKA-së sipas sektorëve të kinematografisë dhe audiovizualit, si dhe administron zbatimin e tij pas miratimit nga Këshilli Drejtues;
  - d) propozon planin kalendarik të thirrjeve publike dhe fondet përkatëse sipas kategorive të mbështetjes financiare;

- e) propozon Programin Kombëtar për Zhvillimin e Krijimtarisë Kinematografike dhe Audiovizuale për miratim nga Këshilli Drejtues dhe është përgjegjës për zbatimin e tij
- f) merr vendime për çështje të organizimit dhe administrimit financiar të AKKA;
- g) nënshkruan kontratat me subjektet përfituese të mbështetjes financiare dhe siguron zbatimin e vendimeve të Këshillit Drejtues;
- h) është përgjegjës për ndjekjen e procedurave të rekrutimit dhe lidhjes së kontratave të punës me punonjësit e AKKA;
- i) miraton vendimet e Këshillit Artistik për mbështetjen financiare. Në rast mos dakordësie, brenda 5 (pesë) ditëve pune, ka të drejtë të kthejë vetëm një herë për shqyrtim në Këshillin Artistik. Këshilli Artistik shqyrton arsyet e kthimit dhe brenda 10(dhjetë) ditëve merr vendim përfundimtar, i cili hyn në fuqi menjëherë.
- j) propozon Komisionin e Vizionimit dhe Komisionin Financiar;
- k) propozon planin kalendarik të thirrjeve publike dhe buxhetet përkatëse sipas kategorive;
- l) merr vendim përfundimtar për përfitimin nga skema e rimbursimit të shpenzimeve (Cash Rebate-it), në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- m) certifikon shpenzimet dhe realizimin e veprës kinematografike dhe audiovizuale sipas skemës mbështetëse të rimbursimit të shpenzimeve;
- h) ushtron detyra të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe në Statutin e AKKA.

## **Neni 14**

### **Këshilli Artistik**

1. Këshilli Artistik është organ kolegjal përgjegjës për vlerësimin dhe miratimin e mbështetjes financiare të produkteve kinematografike dhe audiovizuale. Për produktet kinematografike ngrihet Këshilli Artistik Kinematografik dhe për produktet audiovizuale ngrihet Këshilli Artistik Audiovizual.
2. Këshilli Artistik vlerëson projektet dhe i paraqet për miratim projektet fituese Drejtorit të Përgjithshëm të AKKA. Në rast mos dakordësie, brenda 5 (pesë) ditëve pune, Drejtori i Përgjithshëm i AKKA ka të drejtë të kthejë vetëm një herë për shqyrtim në Këshillin Artistik. Këshilli Artistik

- shqyrton arsyet e kthimit dhe brenda 10(dhjetë) ditëve merr vendim përfundimtar, i cili hyn në fuqi menjëherë.
3. Secili Këshill Artistik përbëhet nga 5 (*pesë*) anëtarë. Anëtarët e Këshillit Artistik zgjidhen nga Këshilli Drejtues, pas thirrjes publike për shprehje interesi.
  4. Anëtarët e Këshillit Artistik duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
    - a) të kenë jo më pak se pesë se 5 (*pesë*) vjet përvojë profesionale në fushën e kinematografisë ose audiovizualit;
    - b) të kenë kontribut të dokumentuar në fushën e kinematografisë dhe audiovizualit, si vepra të realizuara, çmime ose pjesëmarrje në festivale ndërkombëtare;
    - c) të mos jetë larguar nga puna me masë disiplinore;
    - d) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi me dashje.
  4. Anëtarët e Këshillit Artistik nuk mund të jenë:
    - a) punonjës të AKKA;
    - b) autorë të projekteve konkurruese, ose persona me lidhje gjinie, farefisnie a krushqie me ta dhe që ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi;
    - c) producentë ose bashkëproducentë të projekteve konkurruese.
  5. Mandati i Këshillit Artistik është 1 (një) vit, me të drejtë riemërimi.
  6. Kryetari i Këshillit Artistik zgjidhet nga anëtarët në mbledhjen e pare të tij.
  7. Kriteret e hollësishme për përzgjedhjen, funksionimin, kompetencat dhe detyrat e Këshillit Artistik përcaktohen në Statutin e AKKA.

## **Neni 15**

### **Komisioni i Vizionimit**

1. Komisioni i Vizionimit është organ kolegjal, përgjegjës për dhënien e lejes së qarkullimit dhe për klasifikimin e veprave audiovizuale sipas kategorive të përshtatshmërisë për moshën, që shfaqen ose transmetohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Komisioni i Vizionimit përbëhet nga 3 (*tre*) anëtarë, një prej të cilëve është përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për kulturën, ndërsa dy anëtarët e tjerë

emërohen nga strukturat e AKKA. Kryetari zgjidhet me votim nga rradhët e anëtarëve të tij.

3. Anëtarët e Komisionit të Vizionimit propozohen nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohen nga Këshilli Drejtues. Anëtarët kanë mandat 2 (dy) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

4. Komisioni i Vizionimit pajis me leje qarkullimi të gjitha veprat audiovizuale, përfshirë shfaqjet në salla kinemaje, transmetimet televizive, platformat e shërbimeve audiovizuale sipas kërkesës, dhe çdo formë tjetër shpërndarjeje publike.

5. Komisioni i Vizionimit klasifikon veprat audiovizuale sipas kategorive të përshtatshmërisë për moshën, si më poshtë:

a) Kategoria U (Universal) – e përshtatshme për të gjitha moshat;

b) Kategoria PG (Parental Guidance/Mbikëqyrje prindërore) – e përshtatshme për të gjitha moshat, por disa skena mund të kërkojnë udhëzim prindëror;

c) Kategoria 12+ – e përshtatshme për shikuesit mbi 12 vjeç;

ç) Kategoria 15+ – e përshtatshme për shikuesit mbi 15 vjeç;

d) Kategoria 18+ – e kufizuar për shikuesit mbi 18 vjeç.

6. Komisioni i Vizionimit i AKKA-së refuzon pajisjen me leje qarkullimi të veprave filmike dhe audiovizuale kur përmbajtja e tyre cenon rendin kushtetues, sigurinë kombëtare, dinjitetin njerëzor, nxit dhunë, urrejtje ose diskriminim mbi baza race, etnie, gjuhe, gjinie, feje apo bindjeje, cenon mbrojtjen e të miturve ose bie në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi

7. Distributori paraqet kopjen e veprës audiovizuale, e cila duhet të jetë identike me kopjen që do të qarkullojë.

8. Distributori është i detyruar të përgatisë veprën audiovizuale të dubluar ose të subtitruar në gjuhën shqipe. Ndalohet lëshimi i lejes për veprat që nuk plotësojnë këtë kusht. Përfshihen nga ky detyrim veprat audiovizuale që shfaqen gjatë festivaleve të filmit, javëve kulturore ose eventeve të veçanta të miratuara nga AKKA.

9. Kriteret e hollësishme për klasifikimin e veprave audiovizuale dhe procedurat e ankimimit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për kulturën.

10. Rregullat, kushtet dhe dokumentacioni për lëshimin e lejes së qarkullimit përcaktohen në rregulloren e brendshme të AKKA.

## **Neni 16**

### **Komisioni Financiar**

1. Komisioni Financiar është organ kolegjal përgjegjës për vlerësimin financiar të projekteve të paraqitura pranë AKKA dhe mbikëqyrjen e realizimit të fondeve buxhetore.
2. Komisioni Financiar propozohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe miratohet nga Këshilli Drejtues. Komisioni përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë nga struktura e AKKA. Kryetari zgjidhet me vote nga radhët e anëtarëve të tij.
3. Komisioni Financiar ushtron këto detyra:
  - a) vlerëson projektet e paraqitura nga pikëpamja financiare;
  - b) mbikëqyr realizimin e fondit buxhetor në projektet e miratuara;
  - ç) përgatit raporte financiare periodike për Këshillin Drejtues;
  - d) shqyrton raportin financiar dhe lëshon Certifikatën e Shpenzimeve të Kualifikuara për skemën e Rimbursimit të Shpenzimeve (Cash Rebate).
4. Rregullat e hollësishme për funksionimin e Komisionit Financiar, përcaktohen në Statutin e AKKA.

## **Neni 17**

### **Papajtueshmëritë dhe konflikti i interesit**

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, Këshillit Artistik dhe punonjësit e AKKA ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fushën e parandalimit të konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.
2. Anëtarët e Këshillit Drejtues, Këshillit Artistik dhe Drejtori i Përgjithshëm nuk mund të jenë përfitues të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të projekteve që aplikojnë për financim pranë AKKA, gjatë mandatit të tyre dhe për një periudhë 2 (dy) vjet pas përfundimit të mandatit dhe nuk duhet të kenë kontrata në fuqi me AKKA.

## **Neni 18**

## **Programi Kombëtar për Zhvillimin e Krijimtarisë Kinematografike dhe Audiovizuale**

1. Programi Kombëtar për Zhvillimin e Krijimtarisë Kinematografike dhe Audiovizuale (në vijim “Programi Kombëtar”) është dokumenti strategjik i politikave kombëtare në fushën e prodhimit, zhvillimit, shpërndarjes dhe promovimit të veprave kinematografike dhe audiovizuale, mbi të cilin AKKA organizon veprimtarinë dhe prioritetet e saj të mbështetjes financiare për një periudhë 4 (katër) vjeçare.

2. Programi Kombëtar miratohet nga Këshilli Drejtues, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe publikohet në faqen zyrtare të AKKA-s brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga miratimi.

3. Programi Kombëtar përcakton:

a) objektivat strategjike për zhvillimin e sektorit kinematografik dhe audiovizual;

b) prioritetet dhe kategoritë e financimit;

c) masat e posaçme të mbështetjes për autorët debutues, kinemanë autoriale, bashkëprodhimet në pakicë, promovimin dhe barazinë gjinore;

ç) politikat për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe harmonizimin me konventat dhe direktivat e Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Europës;

d) kuadrin financiar orientues dhe ndarjen indikative të buxhetit sipas kategorive të financimit dhe instrumenteve të mbështetjes;

dh) treguesit e performancës, metodologjitë e matjes dhe kriteret e vlerësimit të ndikimit gjatë periudhës së zbatimit.

4. Para miratimit të Programit Kombëtar, AKKA zhvillon konsultim publik me grupet e interesit për një periudhë jo më pak se 30 (tridhjetë) ditë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Zbatimi i Programit Kombëtar realizohet përmes Planit Vjetor të Zbatimit, i cili miratohet nga Këshilli Drejtues jo më vonë se data 31 dhjetor për vitin pasardhës.

6. Drejtori i Përgjithshëm paraqet pranë Këshillit Drejtues Raportin Vjetor mbi zbatimin e Programit Kombëtar jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës. Raporti publikohet në faqen zyrtare të AKKA-s dhe i dërgohet për informim ministrit përgjegjës për kulturën.

7. Programi Kombëtar mund të ndryshohet me vendim të Këshillit Drejtues, pas zhvillimit të konsultimit publik për një periudhë jo më pak se 15 ditë.

Ndryshimet teknike ose ato të diktuar nga ndryshime ligjore mund të miratohen pa konsultim paraprak.

8. Në rast se Programi i ri nuk miratohet brenda afatit, Programi në fuqi vazhdon të zbatohet deri në hyrjen në fuqi të programit pasardhës, por jo më shumë se 12 muaj

## **KREU III**

### **KOMISIONI SHQIPTAR I FILMIT**

#### **Neni 19**

#### **Misioni dhe kompetencat**

1. Komisioni Shqiptar i Filmit krijohet si strukturë e specializuar funksionale brenda AKKA-s, me qëllim zbatimin e politikave për promovimin e Republikës së Shqipërisë si destinacion për prodhimet kinematografike dhe audiovizuale, lehtësimin operativ të tyre dhe nxitjen e investimeve të huaja në sektorin kinematografik dhe audiovizual.
2. Komisioni Shqiptar i Filmit ushtron kompetenca në fushën e:
  - a) informimit, asistencës dhe koordinimit institucional për producentët vendas dhe të huaj;
  - b) promovimit dhe përfaqësimit në rrjetet e bashkëpunimit homolog;
  - c) mbështetjes operative të skemave dhe programeve që lidhen me sektorin kinematografik dhe audiovizual, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
  - ç) vlerëson pranueshmërinë e aplikimit dhe kualifikon shpenzimet të skemës së Rimbursimitit të Shoenzimeve (Cash Rebate);
  - d) shërben si strukturë asistuese dhe koordinuese për producentët vendas dhe të huaj, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse, për marrjen e lejeve të xhirimit në hapësira publike, në objekte të trashëgimisë kulturore dhe në zona natyrore të mbrojtura.
3. Komisioni ushtron funksione ekzekutive, ndihmëse dhe koordinuese, pa kompetenca vendimmarrëse financiare të pavarura. Vendimet që krijojnë detyrime financiare merren nga organet kompetente të AKKA-s.

#### **Neni 20**

#### **Lejet e Xhirimit**

1. Komisioni Shqiptar i Filmit administron Sistemin Kombëtar të Lejeve të Xhirimit, në të cilin paraqiten kërkesat për zhvillimin e prodhimeve audiovizuale në territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Sistemi i Lejeve të Xhirimit funksionon si pikë unike aplikimi përmes së cilës producentët paraqesin kërkesat për:
  - a) leje xhirimi në hapësira publike;
  - b) leje xhirimi në objekte të trashëgimisë kulturore dhe në zona natyrore të mbrojtura.
3. Procedurat e aplikimit, dokumentacioni dhe afatet e shqyrtimit të aplikimeve përcaktohen në rregulloren për lejet, i cili miratohet nga Këshilli Drjetues me propozim të Drejtorit të AKKA.

## **KREU IV**

### **MEKANIZMA TË MBËSHTETJES FINANCIARE DHE INCENTIVA FISKALË**

#### **Neni 21**

##### **Instrumentet e mbështetjes financiare**

1. AKKA mbështet zhvillimin dhe financimin e projekteve kinematografike dhe audiovizuale përmes instrumenteve të mbështetjes financiare, në përputhje me Programin Kombëtar për Zhvillimin e Krijimtarisë Kinematografike dhe Audiovizuale.
2. Instrumentet e mbështetjes financiare dhe fiskale ndahen në dy kategori kryesore, sipas natyrës së ndërhyrjes publike:
  - a) Mbështetja selektive, e cila jepet mbi bazën e vlerësimit artistik, kulturor dhe profesional të projektit, nëpërmjet procedurave konkurruese të thirrjeve publike;
  - b) Mbështetja automatike, e cila përfshin skemën e rimbursimit të shpenzimeve sipas kushteve dhe kriterëve që duhet të plotësojnë subjektet për të përfituar nga kjo skemë.
3. Një projekt mund të përfitojë njëkohësisht nga më shumë se një instrument i mbështetjes financiare.

#### **Neni 22**

## Thirrjet publike

1. Thirrja publike përcakton, të paktën: kategoritë e projekteve të pranueshme; fondin e disponueshëm; kriteret dhe metodologjinë e vlerësimit; afatet dhe mënyrën e aplikimit; si dhe dokumentacionin e kërkuar.
2. Vlerësimi i projekteve bazohet në kriteret e mëposhtme:
  - a) cilësia artistike dhe vlera kulturore;
  - b) realizueshmëria financiare dhe tekniko-produksionale;
  - c) ndikimi ekonomik dhe potenciali për punësim;
  - d) kontributi në promovimin e identitetit kulturor shqiptar;
  - e) niveli i bashkëprodhimeve ndërkombëtare dhe potenciali i qarkullimit ndërkombëtar.
3. AKKA mbështet projektet kinematografike në këto kategori:
  - a) film artistik me metrazh të gjatë – vepër autoriale;
  - b) film artistik me metrazh të gjatë – vepër debutuese dhe e dytë autoriale;
  - c) film artistik me metrazh të shkurtër;
  - d) film dokumentar;
  - e) film i animuar;
  - f) projekte zhvillimi;
  - g) projekte pasprodhimi.
4. AKKA mbështet projektet audiovizuale në këto kategori:
  - a) seriale dhe formate episodike;
  - b) projekte zhvillimi;
  - c) projekte pasprodhimi;
  - d) projekte imersive.
5. AKKA mbështet gjithashtu projekte mbështetëse të sektorit kinematografik dhe audiovizual, përfshirë:
  - a) distribuimin dhe promovimin e veprave;
  - b) bashkëprodhimet në minorancë;
  - c) edukimin, trajnimin dhe zhvillimin profesional;
  - d) projekte të tjera në funksion të zhvillimit të sektorit.
6. Kriteret e detajuara dhe ndarja e fondeve për secilën kategori përcaktohen në Programin Kombëtar dhe në aktet nënligjore të AKKA-s.

## Neni 23

### Rimbursimi i shpenzimeve (Cash Rebate)

1. AKKA rimburson një përqindje të shpenzimeve të kualifikuara të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë gjatë prodhimit të veprave filmike dhe audiovizuale, me qëllim nxitjen e xhirimeve dhe investimeve në Republikën e Shqipërisë.
2. Skema e Rimbursimit të Shpenzimeve (Cash Rebate) synon:
  - a) tërheqjen e investimeve në sektorin kinematografik dhe audiovizual;
  - b) zhvillimin e industrisë kinematografike dhe audiovizuale, si dhe shërbimet e lidhura me to;
  - c) promovimin e Shqipërisë si destinacion për prodhimet ndërkombëtare.
3. Norma e rimbursimit është 35% (*tridhjetë e pese për qind*) e shpenzimeve të kualifikuara të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me rregullat e parashikuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Përfituese të skemës së Rimbursimit të Shpenzimeve (Cash Rebate) janë shtëpitë kinematografike të huaja të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi me shtëpitë kinematografike, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, dhe që realizojnë shpenzime të kualifikuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. Aplikimi dhe rimbursimi i shpenzimeve kryhet në favor të shtëpisë kinematografike vendase.
5. Shpenzimet e kualifikuara i nënshtrohen auditimit nga një auditues i pavarur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Rimbursimi kryhet brenda kufijve të buxhetit vjetor të Fondit të Rimbursimit të Shpenzimeve (Cash Rebate).
7. Rregullat, procedurat, kriteret e pranueshmërisë, procedurat e aplikimit, Fondi i Rimbursimit të Shpenzimeve dhe administrimi i tij, kategoritë e shpenzimeve të kualifikuara dhe mekanizmat e kontrollit për Rimbursimin e Shpenzimeve (Cash Rebate) përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 24**

### **Fondi i Rimbursimit të Shpenzimeve (Cash Rebate)**

1. Fondi i Cash Rebate është një zë më vete në buxhetin vjetor të Ministrisë së Financave për skemën e rimbursimit të shpenzimeve të kualifikuara dhe funksionon me parimin “shërbehet kush vjen i pari”.

2. Vlera vjetore e Fondit përcaktohet çdo vit në ligjin e buxhetit të shtetit, në bazë të:
  - a) parashikimit të kërkesave nga sektori;
  - b) kapaciteteve fiskale të buxhetit të shtetit.
3. Fondi administrohet nga Ministria e Financave në bashkëpunim me AKKA-n, sipas procedurës së miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Fondet e paalokuara gjatë vitit fiskal nuk trashëgohen në vitin pasardhës, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin e buxhetit të shtetit.

## **Neni 25**

### **Procedura e Rimbursimit të Shpenzimeve**

1. Procedura e rimbursimit të shpenzimeve kryhet si më poshtë:
  - a) AKKA shpall thirrjen publike për aplikimin në skemën e Rimbursimit të Shpenzimeve (Cash Rebate);
  - b) Shtëpia kinematografike paraqet aplikimin pranë Komisionit Shqiptar të Filmit para fillimit të xhirimeve, së bashku me dokumentacionin e parashikuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
  - c) Komisioni Shqiptar i Filmit vlerëson pranueshmërinë e aplikimit dhe kualifikon shpenzimet brenda 45 ditëve nga aplikimi;
  - d) Pas përfundimit të prodhimit, shtëpia kinematografike dorëzon raportin financiar të certifikuar nga një auditues i pavarur;
  - e) Komisioni Financiar i AKKA-s shqyrton raportin financiar dhe lëshon Certifikatën e Shpenzimeve të Kualifikuara brenda 60 ditëve nga dorëzimi;
  - f) Drejtori i Përgjithshëm i AKKA-s lëshon vendimin dhe e përcjell në Ministrinë e Financave;
  - g) Ministria e Financave ekzekuton pagesën drejtpërdrejt te shtëpia kinematografike brenda 90 ditëve nga certifikimi përfundimtar.

## **Neni 26**

### **Monitorimi dhe vlerësimi i impaktit ekonomik**

1. AKKA dhe Komisioni Shqiptar i Filmit monitorojnë dhe vlerësojnë impaktin ekonomik dhe kulturor të sektorit filmik dhe audiovizual.
2. Sistemi përfshin mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi:
  - a) vlerën e investimeve të realizuara;
  - b) shpenzimet e kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë;
  - c) numrin e të punësuarve dhe profesionistëve të përfshirë;
  - d) përdorimin e shërbimeve dhe furnitorëve vendas;
  - e) ndikimin në turizëm dhe promovimin e territorit;
  - f) shpërndarjen dhe suksesin ndërkombëtar të veprave audiovizuale.
3. Shtëpitë kinematografike që përfitojnë nga fondet publike ose skemat mbështetëse janë të detyruara të raportojnë periodikisht, sipas kërkesave të përcaktuara nga AKKA dhe Komisioni.
4. Të dhënat e mbledhura përdoren për:
  - a) hartimin dhe përmirësimin e politikave publike;
  - b) vlerësimin e eficiencës së skemave mbështetëse;
  - c) transparencën dhe informimin publik.
5. AKKA dhe Komisioni publikojnë një raport vjetor të sektorit filmik dhe audiovizual, që përfshin analizë të detajuar të impaktit ekonomik dhe kulturor.
6. AKKA publikon një raport vjetor të veçantë mbi zbatimin e skemës së Rimbursimit të Shpenzimeve (Cash Rebate) përfshirë numrin e prodhimeve të mbështetura, shumat e rimbursuara, shpenzimet totale të gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë, punësimin e krijuar dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

## **KREU V**

### **PRODHIMI, TREGTIMI, SHFAQJA DHE REGJISTRI I VEPRAVE FILMIKE DHE AUDIOVIZUALE**

#### **Neni 27**

##### **Shtëpitë Kinematografike**

1. Shtëpia kinematografike është person fizik ose juridik, veprimtaria kryesore e të cilit është prodhimi, bashkëprodhimi, shpërndarja ose shfaqja publike e veprave kinematografike dhe audiovizuale, dhe që gëzon të

drejtën e shfrytëzimit ekonomik mbi veprat që realizon, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

2. Shtëpia kinematografike mban përgjegjësi ligjore, administrative dhe financiare ndaj institucioneve dhe palëve të treta;
  - a) ushtron veprimtarinë në mënyrë të vazhdueshme dhe profesionale;
  - b) siguron dhe administron kapacitetet njerëzore dhe financiare;
  - c) lidh dhe zbaton marrëveshje kontraktuale me palët e treta;
  - d) si dhe garanton respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to.
3. Një shtëpi kinematografike mund të ketë një ose më shumë producentë, të cilët veprojnë brenda këtij subjekti në përputhje me marrëdhëniet kontraktuale dhe organizimin e brendshëm të saj.
4. Shtëpi kinematografike nuk mund të jenë subjektet në të cilat një transmetues mediatik, audiovizual ose operator platforme zotëron, drejtpërdrejt ose tërthorazi, pjesëmarrje në kapital apo ushtron ndikim vendimmarrës, si dhe personat juridikë publikë që nuk ndjekin qëllim fitimprurës.

## **Neni 28**

### **Prodhimi, tregtimi dhe shfaqja e veprave filmike dhe audiovizuale**

1. Prodhimi i veprave kinematografike dhe audiovizuale kryhet nga persona fizikë ose juridikë të cilët ushtrojnë veprimtari në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe janë të regjistruar në regjistrin e prodhuesve të administruar nga AKKA.
2. Tregtimi i veprave filmike dhe audiovizuale kryhet nga personat fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin e distributorëve të AKKA.
3. Shfaqja publike e veprave kinematografike kryhet nga persona fizikë ose juridikë të regjistruar, që ushtrojnë këtë veprimtari në mënyrë të organizuar dhe profesionale dhe që plotësojnë kushtet e mëposhtme:
  - a) disponojnë salla kinemaje në përputhje me standardet teknike, sipas legjislacionit në fuqi;
  - b) janë të regjistruar në regjistrin e kinemave, të administruar nga AKKA;
  - c) janë mbajtës të të drejtave të ligjshme për shfaqjen publike të veprave, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me to.

4. Ndalohet reklamimi i produkteve dhe shërbimeve, reklama e të cilave është e ndaluar me ligj, para, gjatë dhe pas shfaqjes publike.
5. Ndalohet shpërndarja, shitja dhe dhënia me qira e veprave audiovizuale të kategorizuara si të papërshtatshme për moshën e të miturve. Ndalimi zbatohet edhe për shitjet përmes postës, internetit ose çdo mënyre tjetër.

## **Neni 29**

### **Regjistri Kombëtar i Sektorit Kinematografik dhe Audiovizual**

1. Krijohet Regjistri Kombëtar i Sektorit Kinematografik dhe Audiovizual, i administruar nga AKKA, si bazë e integruar e të dhënave për industrinë kinematografike dhe audiovizuale në Republikën e Shqipërisë.
2. Regjistri përmban të dhëna mbi:
  - a) subjektet që ushtrojnë veprimtari në sektorin audiovizual;
  - b) shoqatat kinematografike dhe audiovizuale;
  - c) listën e profesionistëve të sektorit kinematografik dhe audiovizual me të drejtë vote, respektivisht sipas sektorit, për Këshillin Drejtues, në bazë të kontributit të tyre krijues dhe realizues, në të paktën 3 (tre) vepra kinematografike ose audiovizuale të regjistruara në këtë regjistër;
  - d) veprat audiovizuale të prodhuara;
  - e) projektet në zhvillim dhe në prodhim;
  - f) shërbimet dhe kapacitetet teknike;
  - g) lokacionet e xhimit.
3. Regjistrimi në këtë regjistër është i detyrueshëm për subjektet që:
  - a) aplikojnë për mbështetje financiare nga AKKA;
  - b) përfitojnë nga skema e rimbursimit të shpenzimeve;
  - c) ushtrojnë veprimtari profesionale në sektorin kinematografik dhe audiovizual, sipas përcaktimeve në aktet nënligjore.
4. Të dhënat e publikuara në Regjistër, kryhen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretin tregtar.
5. Rregullat e detajuara për formën, përmbajtjen, administrimin dhe përditësimin e të dhënave në Regjistrin Kombëtar i Sektorit Kinematografik dhe Audiovizual përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **Neni 30**

## **Detyrimet e kinemave**

1. Kinematë që ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë janë të detyruara të shfaqin premierat e veprave kinematografike dhe audiovizuale shqiptare ose të bashkëprodhuara, sipas këtyre periudhave minimale:
  - a) për sallat me një ekran, jo më pak se 5 (pesë) ditë radhazi;
  - b) për sallat me dy ose më shumë ekrane, jo më pak se 7 (shtatë) ditë radhazi në të paktën një ekran.
2. Producenti ose distributori njofton kinemën të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së premierës. Kinema ka të drejtë të kërkojë materialet promovuese për veprën audiovizuale.

## **Neni 31**

### **Shoqatat kinematografike dhe audiovizuale**

1. Profesionistët e kinematografisë dhe audiovizualit kanë të drejtë të organizohen në shoqata profesionale në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse.
2. Shoqatat e kineastëve regjistrohen pranë AKKA kur plotësojnë kushtet e mëposhtme:
  - a) të jenë të regjistruara si organizata jofitimprurëse sipas legjislacionit shqiptar;
  - b) të kenë për objekt mbrojtjen dhe promovimin e interesave profesionale dhe financiare të të sektorit të kinematografisë dhe të sektorit audiovizual;
  - c) të kenë të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) anëtarë aktivë që ushtrojnë profesionin në fushën e kinematografisë ose audiovizualit;
  - d) të kenë organizma të zgjedhura sipas statutit të tyre.
3. AKKA administron regjistrin e shoqatave të kineastëve.
4. Rregullat për regjistrimin e shoqatave të kineastëve dhe publikimi i të dhënave përcaktohen në Statutin e AKKA.

## **KREU VI**

## **BASHKËPUNIMI NDËRINSTUCIONAL**

### **Neni 32**

#### **Statusi dhe veprimtaria e Albafilm sh.a.**

1. Albafilm sh.a. është shoqëri aksionare me kapital shtetëror.
2. Albafilm sh.a. ushtron veprimtari në fushën e prodhimit dhe ofrimit të shërbimeve për industrinë kinematografike dhe audiovizuale dhe zhvillimin e infrastrukturës së filmit.
3. Albafilm sh.a. funksionon edhe si Studio Kombëtare e Filmit, me mision ofrimin e shërbimeve profesionale për prodhime vendase dhe ndërkombëtare dhe mbështetjen e industrisë audiovizuale dhe tërheqjen e investimeve.
4. Albafilm sh.a. ofron shërbime për prodhimet filmike dhe audiovizuale si më poshtë:
  - a) shërbime prodhimi dhe bashkëprodhimi (line production);
  - b) dhënie me qira të:
    - i. studiove filmike;
    - ii. hapësirave të xhirimit;
    - iii. pajisjeve teknike;
    - iv. rekuizitave dhe kostumeve;
  - c) shërbime skenografie, ndërtimi dekori dhe mirëmbajtje;
  - ç) shërbime logjistike dhe mbështetje operative;
  - d) shërbime pasprodhimi, sipas kapaciteteve të disponueshme.
5. Albafilm sh.a. vepron si ofrues i integruar shërbimesh për produksione (“production hub”), duke mbështetur:
  - a) organizimin e xhirimeve;
  - b) mobilizimin e burimeve teknike dhe njerëzore;
  - c) koordinimin logjistik në terren.

### **Neni 33**

#### **Administrimi i aseteve dhe arkivave**

1. Albafilm sh.a. administron dhe zhvillon:
  - a) fondin e rekuizitave dhe kostumeve;
  - b) materialet skenografike;
  - c) hapësirat filmike dhe infrastrukturën teknike;

- d) arkiva materiale të lidhura me prodhimin filmik.
- 2. Asetet vihen në dispozicion të industrisë sipas tarifave të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme.

### **Neni 34**

#### **Arkiva e filmit**

1. Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit përveç funksioneve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, mbështet industrinë kinematografike dhe audiovizuale nëpërmjet:
  - a) vënies në dispozicion të materialeve arkivore për prodhime kinematografike dhe audiovizuale;
  - b) ofrimit të shërbimeve kërkimore dhe dokumentare për producentët;
  - c) bashkëpunimit me Albafilm sh.a. dhe Komisionin Shqiptar të Filmit.
2. Përdorimi i materialeve arkivore për qëllime tregtare bëhet sipas tarifave të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për kulturën dhe ministrit përgjegjës për financat.
3. Veprat kinematografike dhe audiovizuale konsiderohen trashëgimi kulturore dhe depozitohen në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit.
4. Prodhuesit e veprave kinematografike dhe audiovizuale të financuara plotësisht ose pjesërisht nga AKKA janë të detyruar të depozitojnë një kopje dixhitale master të veprës së përfunduar pranë Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i prodhimit. Formatit dhe specifikimet teknike përcaktohen në Statutin e AKKA.

### **Neni 35**

#### **Koordinimi me Autoritetin e Mediave Audiovizuale**

1. Zbatimi i këtij ligji realizohet në bashkëpunim ndërinstitucional, duke koordinuar veprimet me Autoritetin e Mediave Audiovizuale dhe institucionet përgjegjëse sipas fushës së përgjegjësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Në rastet kur shkeljet e parashikuara në këtë ligj lidhen me transmetime audiovizuale ose shërbime të mediave audiovizuale, zbatimi i dispozitave

për mbrojtjen e të miturve dhe klasifikimin sipas moshës koordinohet me Autoritetin e Mediave Audiovizuale, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mediat audiovizive.

## **KREU VII**

### **DISPOZITA TRANZITORE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 36**

#### **Dispozita tranzitore**

1. Agjencia Kombëtare e Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA) fillon funksionimin brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe ushtron funksionet, kompetencat dhe përgjegjësitë e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK).
2. Gjatë periudhës tranzitore, deri në fillimin e funksionimit të AKKA, QKK vijon të ushtrojë funksionet e saj sipas legjislacionit në fuqi. Me fillimin e funksionimit të AKKA, QKK pushon së ekzistuari.
3. AKKA merr përsipër të gjitha të drejtat, detyrimet, marrëdhëniet juridike, si dhe çdo procedurë administrative apo gjyqësore në proces.
4. Shoqëria tregtare shtetërore Albafilm sh.a vijon të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi.
5. Kontratat e financimit dhe çdo marrëdhënie tjetër juridike e lidhur nga QKK mbeten në fuqi dhe ekzekutohen nga AKKA, e cila zëvendëson QKK në të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Projektet e miratuara për financim sipas procedurave të QKK-së përfundojnë sipas rregullave dhe kushteve në fuqi në momentin e aplikimit.
6. Marrëveshjet dhe kontratat ekzistuese ndërmjet QKK dhe Albafilm sh.a vijojnë të mbeten në fuqi dhe transferohen tek AKKA, e cila hyn në të drejtat dhe detyrimet përkatëse, përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe.
7. Punonjësit e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK) transferohen në Agjencinë Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA), duke ruajtur të drejtat e fituara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës.

8. Për një periudhë tranzitore, jo më shumë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga fillimi i funksionimit të AKKA, struktura dhe pozicionet ekzistuese të punës ruhen, për aq sa është e nevojshme për garantimin e vijimësisë së funksioneve. Riorganizimi i strukturës dhe organikës kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
9. Asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, inventari, dokumentacioni, arkivat, si dhe çdo e drejtë pasurore dhe jopasurore në administrim ose pronësi të QKK kalojnë në administrim të AKKA, sipas procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për administrimin e pasurisë shtetërore.
10. Ministri përgjegjës për kulturën fillon procedurat për emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA) brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm përfundon jo më vonë se data e fillimit të funksionimit të AKKA.
11. Deri në emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKA, kryetari i emëruar i QKK ushtron funksionet e drejtimit dhe administrimit të AKKA për periudhën tranzitore.

## **Neni 37**

### **Aktet nënligjore**

1. Statuti i Agjencisë Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA), sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 4 të këtij ligji përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për kulturën, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Tarifat për shërbimet dhe regjistrimet e AKKA, të parashikuara në pikën 4 të nenit 6 të këtij ligji përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për kulturën brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Kriteret e hollësishme për klasifikimin e veprave audiovizuale dhe procedurat e ankimimit, të parashikuara në pikën 9 të nenit 15 të këtij ligji, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për kulturën brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
4. Rregullat, procedurat, kriteret e pranueshmërisë, procedurat e aplikimit, Fondi i Rimbursimit të Shpenzimeve dhe administrimi i tij, kategoritë e shpenzimeve të kualifikuara dhe mekanizmat e kontrollit për Rimbursimin e Shpenzimeve (Cash Rebate) të parashikuara në pikën 7, të nenit 23 të këtij

ligji, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. regullat e detajuara për formën, përmbajtjen, administrimin dhe përditësimin e të dhënave në Regjistrin Kombëtar i Sektorit Kinematografik dhe Audiovizual, të parashikuar në pikën 5, të nenit 29 të këtij ligji, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
6. Transferimi i pronësisë 100% të aksioneve të shoqërisë “Albafilm” sh.a., Tiranë, nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit te Agjencia Kombëtare e Kinematografisë dhe Audiovizualit, të parashikuar në pikën 6, të nenit 32 të këtij ligji, përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

### **Neni 38**

#### **Shfuqizimet**

1. Ligji nr. 8096, datë 21.3.1996, "Për kinematografinë", i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Çdo dispozitë e akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullon çështje të parashikuara shprehimisht në këtë ligj dhe që bie në kundërshtim me të, nuk zbatohet.

### **Neni 39**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

**NIKO PELESHI**